



VENDIM

Nr. 28 Datë 15.02.2017

MBI

**MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË KOMP ENERGJI”
SH.P.K., ME NUMËR. 248, SERIA PV14K, MIRATUAR ME VENDIMIN
E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR.94, DATË 06.10.2014, PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “HURDHAS
1”, “HURDHAS 2” DHE“HURDHAS 3”.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, pika 1 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së Nr. 840, datë 11.06.2008 “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll”; nenit 15 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.06.2016, të Bordit të ERE; nenit 8, të Kontratës Koncesionare, nr. 2807 Rep, dhe nr. 371 Kol, datë 01.09.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.02.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me modifikimin e licensës së aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë Komp Energji sh.p.k.,

Konstatohet se:

- Shoqëria Komp Energji sh.p.k ka kryer pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit siç përcaktohet në aneksin “A” të kësaj rregullorje, si dhe pagesën e rregullimit për vitin 2015 dhe rezulton i çliruar nga çdo lloj detyrimi financiar ndaj ERE.
- Shoqëria “Hidropowerplant Construction sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 9 (Formati dhe dokumentacioni për aplikim) të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë licensën e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec-et “Hurdhas 1, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3 me numër 248, seria PV14K, miratuar me me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr.94, datë 06.10.2014, duke e zëvendësuar emrin e shoqërisë së licencuar “Komp Energji” sh.p.k, me shoqërinë Hidropowerplant Construction sh.p.k.
2. Të njoftohet shoqëria “Komp Energji” sh.p.k, që të depozitohet në ERE, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, licensën e prodhimit numër 248, Seria PV14K, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 94, datë 06.10.2014.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet Ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI